



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE *MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 19 pika ë e Statutit të Komunës së Prishtinës, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi qeverisjen e komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2003 mori :

V E N D I M
MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM SHOQATËS GJERMANE “SCHUELER HELFEN LEBEN E V”, SHTËPINË E HIVZI SYLEJMANIT NË PRISHTINË

I

I jepet në shfrytëzim shtëpia e Hivzi Sylejmanit në Prishtinë, Shoqatës Gjermane “Schueler Helfen Leben e V”, prej 03.02.2003 deri më 31.08.2003.

II

Obligohet Shoqata Gjermane “Schueler Helfen Leben e V” që brenda afatit të caktuar ta bëjë aftësimin e objektit.

III

Për realizimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini, Sport dhe Gjini i Komunës së Prishtinës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 361-194 Data.31.01.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri